



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 100/1 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 28/06 / 2021

VENDIM

Nr.26, date 28 /06/2021

PËR

PLANIN E GADISHMERISE NE RAST TE EMERGJENCAVE CIVILE TE SHKAKTUARA NGA SHFRYTEZIMI I DIGES SE URES SE FANIT E HEC FAN

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" si dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e datës 28.06.2021 mori në shqyrtim Planin e Gadishmerise në rastet e emergjencave civile (PGEC) të shkaktuara nga shfrytëzimi i diges së Ures së Fanit të HEC FAN.

Bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur nga Kompania AYEN AS si shfrytëzues i kësaj dige, kushtet aktuale të diges, si dhe kërkesave të legjislacionit të mesiperm, KKDM,

VENDOSI:

- 1- Të Miratojë Planin e Gadishmerise në rastet e emergjencave civile të paraqitur nga Kompania AYEN AS si shfrytëzues e diges së Ures së Fanit të HEC FAN
- 2- Ti kërkoj Kompanisë AYEN si shfrytëzues i digës dhe nënobjekteve të saj:
 - Kryerjen e Provave për zbatimin e këtij Plani dhe funksionimin e sistemit të alarmit për digën e Ures së Fanit brenda muajit Nendor 2021. Këto Prova duhet të kryhen në bashkëpunim me pushtetin lokal dhe përfaqësuesit e Prefekturës së zonës ku ndodhet Diga.
 - Publikimin e PGEC dhe Njohjen e të gjithë aktoreve të përfshirë në këtë Plan me skenaret e parashikuar në këtë plan, hartën e përmbajtjeve si dhe veprimet që duhet të kryhen në kuadër të zbatimit të këtij Plani.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

